



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës

Nr. 401-15763 / 25

Datë: 28.05 / 25

NJOFTIM PËR DËGJIMET BUXHETORE

Bazuar në LIGJI NR. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësit, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Kuvendi Komunal Klinë në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, hapin procesin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore - KAB 2026-2028. Korniza afatmesme Buxhetore komunale paraqet një përmbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2026-2028 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentat strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës. KAB 2026-2028 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti vjetor për vitin 2026. Konsultimi publik është i hapur nga data 28 maj 2025, deri më 24 qershor 2025.

Ftohen të gjitha institucionet komunale, Qytetarët, OJQ-të, Bizneset, Bashkësitë Lokale, Mediat dhe grupet tjera të interesit që të marrin pjesë në Dëgjimet Buxhetore për KAB 2026 – 2028, më këtë;

RENDI I DITËS

SHQYRTIMI I KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE 2026-2028.

Takimet do të mbahen sipas këtij planifikimi:

TAKIMI I – Salla e Konferencave, në Komunën e Klinës, me Kryetarët e Këshillave të Fshatrave, datë 05.06.2025, ora 10:00,

TAKIMI II - SHFMU “Isa Boletini”, në fshatin Poterç i Epërm, më banorët e fshatrave Poterç i Epërm, Poterç i Poshtëm, Drenoc dhe Dugajevë, **datë 05.06.2025, ora 17:00,**

TAKIMI III- SHFMU “Azem Bejta”, në fshatin Grabanicë, më banorët e fshatrave Grabanicë, Dollovë, Bokshiq, Këpuz dhe Qeskovë, **datë 05.06.2025, ora 18:30,**

TAKIMI IV - SHFMU “Motrat Qiriaz”, në fshatin Zajm, më banorët e fshatrave Zajm, Gremnik, Deiq, Dolle dhe Dresnik, **datë 09.06.2025, ora 17:00,**

TAKIMI V - SHFMU “Avni Zhabota”, në fshatin Shtupel, më banorët e fshatrave Shtupel, Kërnice, Binxhë, Grabc, (komunitetin joshumicë), **datë 09.06.2025, ora 18:30,**

TAKIMI VI - SHFMU “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë, me banorët e fshatrave Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Resnik, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Ujmirë, Doberdol, **datë 10.06.2025, ora 17:00,**

TAKIMI VII – SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës”, në fshatin Gllarevë, me banorët e fshatrave Gllarevë, Sferkë, Caravik, Volljakë, Zabergjë, Përçevë, **datë 10.06.2025, ora 18:30,**

TAKIMI VIII - SHFMU “Atë Shtjefën Gjeçovi”, në fshatin Zllakuqan, më banorët e fshatrave Zllakuqan, Berkovë, Ranoc, Leskoc, Nagllavë, Dranashiq, Stupë, Rudicë, Jagodë, Videjë, Krushevë e Madhe dhe Budisalc, **datë 11.06.2025, ora 17:00,**

TAKIMI IX – Shtëpia e Kulturës “Jehona e Dukagjinit”, me temë “Prioritetet e grave dhe të rinjve të komunës së Klinës, **datë 11.06.2025, ora 16:00,**

TAKIMI X - Salla e Kuvendit Komunal Klinë, takim i përgjithshëm me banorët e Komunës së Klinës, qytetit dhe lagjeve, **datë 12.06.2025, ora 10:00.**

Materiali në formë fizike mund të merret në Zyrën për Punë të Kuvendit, Zyrën e Kryetarit si dhe Zyrën e Drejtorisë së Financave, po ashtu, gjendet edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Klinës si dhe Platformën e Konsultimeve Publike:

Komuna Klinë:

<https://kline.rks-gov.net/konsultimet-publike/>

Platforma e Konsultimeve Publike:

<https://konsultimet.rks-gov.net/consultations.php?InstitutionID=20514&OpenPage=0&ClosedPage=0>

Propozimet e juaja lidhur me këto akte mund t’i dorëzoni me shkrim në Zyrën e Kuvendit, kati I, zyra e dytë, korridori në anën e djathtë si dhe Zyra e Kryetarit, kati II, zyra parë.

Gjithashtu, në mënyrë elektronike tek zyrtarët:

1. Vlora Tafili, email: vlora.tafili@rks-gov.net
2. Melihate Behramaj, email: melihate.behramaj@rks-gov.net;

Mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja nga data **28.05.2025**, gjatë mbajtjes së dëgjimit dhe deri me datën **24.06.2025** nëpërmes mjeteve elektronike.

Pas përfundimit të fazës së diskutimit publik, propozimet e juaja do të merren në konsideratë duke u shqyrtuar në raportin e konsultimit publik si dhe në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës konform dispozitave ligjore.

Kryetari i Komunës,
Zenun Elezaj



Kryesuesi i Kuvendit Komunal,
Fadil Gashi

